



Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Nr. 325/10

Vushtri, më 17.09.2010

Në bazë nenit 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenit 62.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 dhe nenit 18 dhe 49.2 të Ligjit për Shëndetësi, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Vushtri**
- **I.Vendi i punës: Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri**

Numri i ekzekutuesve: një (1).

Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së në punët profesionale të QKMF-së e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e ligjit, statutit dhe akteve tjera nënligjore;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- -Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Republikës së Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale , planin e punës për buxhetin e QKMF-së për vitin vijues ;
- Është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore ;
- Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale zbaton buxhetin e QKMF-së;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
- Zhvillon marrëdhënie të mira me donatorët, OJQ-të dhe me partnerët për zbatimin e tyre;
- Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
- Për punën e tij i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

-Doktor Specialist nga Mjekësia Familjare

-Licenca e punës

-Pesë(5) vite përvojë pune në shëndetësi

-Certifikata mjekësore CM 0102

Kushtet e dëshiruara

-Përvoja në procesin e implementimit të Mjekësisë Familjare;

-Trajnimet në menaxhmentin shëndetësor dhe shëndetësi publike

Periudha e kontratës:

Tre muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 3 vite.

Paga:Koeficienti 12

Dokumentacioni i nevojshëm:

-Diploma mbi kualifikimin

-Certifikata e lindjes

-Kopja e letërnjoftimit

-Dëshmi mbi përvojën e punës

-Certifikata që dëshmojnë njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera.

II.Vendi i punës:Drejtor i Qendrës për Punë Sociale-Vushtrri

Numri i ekzekutuesve një (1)

Detyrat kryesore:

-Të informojë të gjithë stafin e QPS-së lidhur me detyrat e punës, të organizojë dhe mbikëqyrë punën e tyre;

-Udhëheq takimet e ekipeve(Kolegjiimet profesionale);

-Udhëheq mbledhjet e stafit lidhur me realizimin e strategjisë së punës në kuadër të QPS-së dhe implementimin e legjislacionit ekzistues ;

-Bënë vlerësimin e punës së punëtorëve para skadimit të kontratave të punës dhe punës provuese;

-Bënë përcjelljen e nevojave sociale në lëmit për të cilat QPS-ja është përgjegjëse, në mënyrë që të përcaktohen prioritetet e aktiviteteve sociale;

-Bënë planin vjetor të punëve

-Bashkëpunon me Organizata Qeveritare dhe OJQ që merren me mirëqenie sociale.

Përgjegjësitë:

-Është përgjegjës për punët menaxheriale dhe buxhetore të QPS-së

Aftësitë kryesore:

-Aftësi për të mbikëqyrë personelin, duke përfshirë organizimin, programimin e detyrave të punës dhe caktimin e prioriteteve;

-Aftësi të mira udhëheqëse dhe kompetencë për krijimin e një ambienti të bashkëpunimit me personelin e QPS-së

-Njohja e gjuhës shqipe dhe serbe,

-Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme;

-Posedimi i patentë shoferit është i dëshirueshëm.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

-Përgatitja universitare në shkencat shoqërore për punëtor social, sociolog, psikolog, pedagog, jurist ose fakulteti ekonomik me përvojë pune 5 vjeçare.

-Përvojë pune 3 vjeçare në vend udhëheqës në institucione, e dëshiruar përvoja e punës në lëmin e mbrojtjes sociale

Kontrata e punës; 3 muaj punë provuese me mundësi vazhdimi deri në 3 vjet.

Koeficienti i pagës:9

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet,të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Sektorin për menaxhimin e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Drejtori i Drejtorisë për shëndetësi dhe përkujdesje sociale
Dr. Safet Idrizi**